



Anemia drepanocitare:

Le të mësojmë ta njohim




Çfarë është anemia drepanocitare?

Anemia drepanocitare, e quajtur edhe drepanocitozë ose anemi falciforme, është një **sëmundje e trashëgueshme**, e cila shkaktohet nga prania brenda rruazave të kuqe të gjakut të një forme të ndryshme **hemoglobine**, proteinë që transporton **oksigjenin** nga mushkëritë tek të gjitha indet e organizmit. ⁽¹⁾

Prania e **hemoglobinës mutante (HbS)** është shkak i një **ndryshimi të gjenit Hb**, i cili shkakton formën karakteristike si drapër të rruazave të kuqe të gjakut dhe që mund të **trashëgohet** nga prindërit. ⁽²⁾

Për të lindur me anemi drepanocitare, një **fëmijë duhet të trashëgojë** një kopje të gjenit mutant nga **të dy prindërit**. Kjo mund të ndodhë edhe në rastin kur të dy prindërit janë **“bartës të shëndetshëm”**, d.m.th. nuk janë të prekur nga anemia drepanocitare, por kanë një kopje të gjenit mutant (gjendje që njihet edhe si **“tipar i qelizave drapër”**). ⁽³⁾

Çfarë mund të ndodhë nëse të dy prindërit janë bartës të shëndetshëm të tiparit të qelizave drapër:







Nëse një nga prindërit është bartës i shëndetshëm, por tjetri jo, (d.m.th. nuk paraqet as anemi drepanocitare dhe as tipar të qelizave drapër), **nuk është e mundur që të lindë një fëmijë me këtë patologji**. ⁽¹⁾

Llojet e ndryshme të anemisë drepanocitare

Ekzistojnë disa ndryshime të gjenit Hb që, të kombinuara me gjenin HbS, shkaktojnë **lloje të ndryshme të anemisë drepanocitare**: ⁽⁴⁾

- HbSS
- HbSC
- HbS β-talasemi
- HbSD, HbSE, HbSO



Rruazat e kuqe në formë drapri



Rruazë e kuqe normale

Rruazat e kuqe normale kanë një formë të ngjashme me një disk, janë **elastike** dhe **rrjedhin lehtësisht** edhe në enët e gjakut më të vogla.⁽¹⁾



Rruazë e kuqe në formë drapri


Rruazat e kuqe në formë drapri kanë një formë të pazakontë, si **drapër** ose **gjysmëhënë**, janë ngjitëse dhe të ngurta.⁽¹⁾



Hemoliza dhe anemia



Rruazat e kuqe në formë drapri çahen më shpejt se ato të shëndetshme (proces i njohur si "**hemolizë**") dhe kjo çon në **anemi** kronike (që mund ta bëjë një person të ndihet i pafuqishëm dhe i lodhur).⁽¹⁾

Gjeni i **dëmtuar** HbS bën që rruazat e kuqe të bëhen **të ngurta**, në **formë drapri** dhe të paafta për të rrjedhur mirë në gjak.⁽¹⁾



Kriza vazookluzive (VOC): shenja dalluese e anemisë drepanocitare⁽⁵⁾


Nëaneminë drepanocitare, përveç rruazave të kuqe, preken edhe **enët e gjakut** dhe qeliza të tjera gjaku, si **rruazat e bardha** dhe **pllakëzat**.⁽⁵⁾



Formimi i grumbujve qelizorë

Për shkak të efektit të molekulave ngjitëse (**selektinave**), të cilat janë veçanërisht **të bollshme** dhe **aktive** te personat me këtë sëmundje, qelizat e gjakut priren **të grumbullohen** dhe të **ngjiten** te muret e enëve të gjakut.⁽⁶⁾

Kjo çon në **bllokimin e enëve të gjakut**, duke shkaktuar **dëmtim të indeve** nga furnizimi i pakët ose mungesa e furnizimit me **oksigen**. Ky fenomen është në thelb të të ashtuquajturave kriza **vazookluzive (VOC)**.⁽⁷⁾



Studimet e fundit sugjerojnë që okluzioni vaskular dhe inflamacioni përkatës janë shkaqet e mundshme të dhimbjes së sëmundjes drepanocitare.⁽⁵⁾

Si shfaqen krizat vazookluzive (VOC)

Krizat vazookluzive (VOC) janë ngjarje episodike, të përsëritura dhe të paparashikueshme të shoqëruara me **dhimbje akute**.⁽⁸⁾ Ato ndodhin me **shpeshtësi** dhe **intensitet** të ndryshueshëm në pjesë të ndryshme të trupit.⁽⁵⁾



Krizat VOC mund të zgjatin deri në **10 ditë**.⁽⁹⁾



Mes pacientëve të prekur nga anemia drepanocitare, **krizat VOC janë** shkaku kryesor i shtrimit në **spital dhe i pranimeve në urgjencë**.⁽¹⁰⁾



Edhe krizat që trajtohen në shtëpi mund të jenë VOC. Në fakt, një studim ka treguar se rreth **25%** e krizave VOC trajtohen brenda **mureve të shtëpisë**.⁽¹¹⁾


Krizat VOC mund të shfaqen në çdo pjesë të trupit, për shembull:



Duar-këmbë
(sidomos të fëmijët)⁽⁵⁾



Kraharor
(brinjë dhe dërrasa
e kraharorit)⁽⁵⁾



Lokalizim
muskuloskeletor⁽¹²⁾



Është e rëndësishme të monitorohet çdo krizë dhimbjesh dhe të informohet mjeku përkatësisht.

Cilat janë simptomat kryesore të anemisë drepanocitare?



Dhimbje⁽⁵⁾



Lodhje⁽¹³⁾



Çrregullime të kyçeve⁽¹³⁾



Dhimbje koke⁽¹³⁾




Stres⁽¹⁾



Dispne⁽¹⁴⁾



Ankth dhe depresion⁽¹⁵⁾



Pagjumësi⁽¹⁴⁾



Verdhëz
(zverdhje e syve dhe
lëkurës)⁽¹⁾



Daktilit
(ënjtje e dhimbshme e
duarve dhe këmbëve)⁽⁵⁾

Anemia drepanocitare është një patologji komplekse që **mund të prekë të gjitha organet dhe indet e trupit**.⁽¹⁶⁾

Shqetësimet që shkakton anemia drepanocitare **mund të trajtohen dhe të parandalohen** me barna dhe me masa që përmirësojnë cilësinë e jetës.⁽¹⁾

Masa të vogla mund të sjellin ndryshim të madh

Trajtimi



Ndiq një **rrugë** trajtimi në **një qendër të specializuar**.⁽¹⁷⁾



Kryej kontrollet që kërkon mjeku yt specialist.⁽¹⁷⁾



Sigurohu të ndjekësh **planin e trajtimit që të ka dhënë mjeku yt**.

Kujdesi personal



Bëj ushtrime **relaksuese** dhe **të frymëmarrjes** për të **reduktuar stresin**.⁽¹⁾

Gjendja shëndetësore



KËSHILLOHET hidratimi **i duhur** (të paktën 2 litra/ditë, por jo më shumë se 4 litra/ditë) sidomos në muajt e nxehtë.⁽¹²⁾



Shmang ekspozimin në **temperatura ekstreme** (p.sh. ftohtë-nxehtë, larje me ujë të ftohtë, ambientet me ajër të kondicionuar).⁽¹²⁾




Bëj **vaksinat parandaluese** sipas planit të vaksinimit për pacientët me anemi drepanocitare.⁽¹²⁾



Përpara se të nisësh një shtatzëni, këshillohet të bësh një **konsultë gjenetike** dhe, nëse ke mbetur tashmë shtatzënë, duhet të organizohet një konsultë sa më shpejt që të jetë e mundur.⁽¹²⁾

Monitorimi



Mos harrotë **mbash shënim** dhe t'ia **raportosh** mjekut tënd të gjitha **dhimbjet që ke pasur**, edhe ato që ke trajtuar vetë në shtëpi.



Në rast emergjence, tregoji **personelit të urgjencës** për gjendjen tënde shëndetësore dhe mos harro të marrësh gjithnjë me vete gjithë **dokumentacionin e nevojshëm**.



Mos **nënvlerëso asnjë simptomë**, as ato më të lehtat.



Bibliografia

1. Anemia drepanocitare. ISS. Disponohet në: <https://www.issalute.it/index.php/la-salute-dalla-a-alla-z-menu/a/anemia-falciforme/> / Aksesi i fundit - dhjetor 2022
2. Zhang D, et al. Blood. 2016;127(7):801-809.
3. Thalassemia International Federation. Drepanocitosi. Available at: <https://thalassaemia.org.cy/it/haemoglobin-disorders/sickle-cell-disease/> Aksesi i fundit - dhjetor 2022
4. Ashorobi D, et al. Sickle Cell Trait. In: StatPearls. Treasure Island (FL): StatPearls Publishing; July 23, 2021.
5. Puri L, et al. Paediatr Drugs. 2018;20(1):29-42.
6. Darbari DS, et al. Eur J Haematol 2014; 93 (2): 89-95.
7. Liu Y et al. Blood 2019; 134 (7): 579-590.
8. Tran H, et al. Blood 2017; 130 (22): 2377-2385
9. Jacob E, et al. J Pain Symptom Manage 2005; 29 (4): 392-400.
10. Ballas SK, et al. Blood 2012; 120 (18): 3647-56.
11. Osunkwo I, et al. Am J Hematol 2021;96 (4): 404-417
12. De Franceschi I, Graziadei G, Rigano P, Cianciulli P, Forni GL. Raccomandazioni per la gestione del paziente adulto affetto da anemia falciforme della Società Italiana Talassemie ed Emoglobinopatie – SITE. Collana Scientifica n.2, 2014
13. Sickle cells disease-Symptoms. NHS. Available at: <https://www.nhs.uk/conditions/sickle-cell-disease/symptoms/> Aksesi i fundit - dhjetor 2022
14. Sharma S, et al. J Clin Sleep Med. 2015;11(3):219-223.
15. Brandow AM, Hematol Oncol Clin North Am. 2018;32(3):535-550.
16. Piel FB, et al. N Engl J Med. 2017;376(16):1561-1573.
17. Living with sickle cells disease. CDC. Available at: <https://www.cdc.gov/ncbddd/sicklecell/healthyliving-living-well.html/> Aksesi i fundit - dhjetor 2022



STRADEARTS
URBAN GALLERY TEMI MILANO

NOVARTIS

Novartis Farma S.p.A. Viale Luigi Sturzo 43, 20154 Milano, Italia

Material informues mbi patologjinë
Kodi 1237747. Kodi i subjektit 10221533000

Janar 2023